



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport  
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport

13 Nr. Zyrtar – 2025

Me datë: 27.03.2025

-XIII- Nr. i prot. 09 Më Dt. 08.04.2025  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores – MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike me Nr. Prot. 488 të datës 19.02.2025, dhe në mbështetje të vendimit me Nr. Prot.5399 të datës 12.03.2025 për caktimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në kulturë nga DKRS-ja për vitin 2025, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

### VENDIM

1. Për ndarjen e përfutësëve sipas projekteve për OJQ-të që i kanë përmbushur kushtet dhe kriteret për subvencionim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, sipas thirrjes publike për aplikim e subvencionimit të OJQ-ve në komunën e Rahovecit.
2. Bashkëngjitur me këtë vendim është lista e përfutësëve të subvencioneve në Kulturë.

#### LISTA E OJQ-ve PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE NË SEKTORIN E KULTURËS

| Nr. | Emri i OJQ-së            | Tutulli i projektit                                               | Shuma    |
|-----|--------------------------|-------------------------------------------------------------------|----------|
| 1.  | Art Studio               | Simpoziumi ndërkombëtar artit –Edicioni 24                        | 6.500 €  |
| 2.  | Dance Pri Fest           | Mbretëresha e fundit                                              | 2.500 €  |
| 3.  | SH.K.A Rahoveci          | N'konak të Rahovecit na bashkon kënga shqipe                      | 6.000 €  |
| 4.  | OJQ Eksodi 99            | Shënimi i 26 – vjetorit të "Eksodit 99"                           | 1.500 €  |
| 5.  | Forumi Anadrini – FARD   | Monografia e gjenocidi i serbisë në komunën e Rahovecit 1998-1999 | 6.000 €  |
| 6.  | Shoqata e Gruas Fra      | Trashëgimia kulturore për mes duarve të grave                     | 2.500 €  |
| 7.  | OVL-UÇK                  | Organizimi i manifestimeve për dëshmorët e kombit                 | 12.000 € |
| 8.  | Q.K.A Jehona e Anadrinit | Festivali Folklorik " Anadrinia Jehon 2025" edicioni i 24         | 17.000 € |
| 9.  | SH.K.A Bajram Curri      | Kultivimi i vlerave kombetare dhe manifestimi i 50- vjetorit      | 11.000 € |

## Arsyetim

Me vendim të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, me Nr.prot.5399, të datës 12.03.2025, është formuar komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës për vitin 2025.

Komisioni ka bërë hapjen dhe vlerësimin e aplikacioneve të cilët kanë konkuruar për subvencione në DKRS-ë, për vitin 2025 duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike për aplikim.

Nga gjithsej dhjetë (10) aplikacione të pranuar, komisioni ka vlerësuar se kriteret për subvencionim i kanë përmbushur nëntë (9) prej tyre, ndërsa një (1) është refuzuar për mungesë dokumentacioni.

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me OJQ-të, përfitues të subvencioneve komunale.

**Udhëzim Juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankesë në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e publikimit të tij pranë Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës.

Ankesa dorëzohet në sportelin Nr. 7 në katin e I-rë në objektin e Komunës.

### Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:

1. Shëdat Ukaj – Kryesues - \_\_\_\_\_
  2. Ardian Rama – Anëtar - \_\_\_\_\_
  3. Blerta Hasani - Anëtar - \_\_\_\_\_
  4. Muharem Morina - Anëtar - \_\_\_\_\_
  5. Lahuta Dula - Anëtare - \_\_\_\_\_
- 